



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi
Mbledhja nr. 23 -2008
Prishtinë, më 16 tetor 2008, ora 9:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni, Adem Salihaj, Ramadan Gashi, Selvije Halimi, Kolë Berisha, Armend Zemaj, Bajram Kosumi, Adem Hajdaraj dhe Džezair Murati.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Munguan: Branislav Grbiq dhe Riza Smaka.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit, me këtë

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 17 shtatorit 2008;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për faljen;
4. Përgatitjet për vizitën në Gjykatën e Qarkut të Pejës;
5. Shqyrtimi i kërkesës së Nora Sahatçiu;
6. Shqyrtimi i kërkesës së Besim Susurit për interpretimin e dispozitës së nenit 138 të ligjit për trashëgiminë.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari i njoftoi të pranishmit për propozimin e rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 17 shtatorit 2008

Kryetari i pyeti anëtarët e Komisionit a kanë vërejtje eventuale për procesverbalin.

Procesverbali i 17 shtatorit 2008 do të miratohet në një nga mbledhjet e ardhshme të Komisionit.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për faljen

Kryetari i njoftoi anëtarët e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për Projektligjin për faljen dhe shtoi se i plotëson kushtet për procedim të mëtutjeshëm.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës Komisioni njëzëri vendosi që Projektligji për faljen të miratohet në parim nga Komisioni

4. Përgatitjet për vizitë në Gjykatën e Qarkut të Pejës

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi i ka bërë të gjitha përgatitjet që më 16 tetor 2008 ta vizitojë Gjykatën e Qarkut të Pejës. Agjenda kësaj vizite është:

1. Takimi me kryetarin e Gjykatës së Qarkut,
2. Biseda me gjyqtarët e Gjykatës së Qarkut.

Komisioni i ka bërë të gjitha përgatitjet për realizimin e kësaj vizite dhe do të diskutojë me autoritetet e Gjykatës së Qarkut të Pejës rreth çështjes së implementimit të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe për çështje të tjera. Për këtë vizitë Komisioni do ta përgatitë një raport.

5. Shqyrtimi i kërkesës së Nora Sahatçiu lidhur me letrën e bardhë

Kryetari, në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës, i njoftoi anëtarët e Komisionit për letrën dhe përmbajtjen e saj për mijëvjeçarin.

6. Shqyrtimi i kërkesës së Besim Susurit për interpretimin e dispozitës së nenit 138 të ligjit për trashëgimin

Kryetari dhe anëtarët e Komisionit u pajtuan që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për një nga mbledhjet e ardhshme të Komisionit.

Procesverbali u hartua nga stafi mbështetës i Kuvendit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni